



01 Nr. 371/26 Dt. 10.08.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për formimin e Komisionit

1. Formohet dhe emërohet Komisioni për vlerësimin e kërkesave lidhur me subvencionimin e transportit urban në Prizren. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
 - 1.1. Alban Krasniqi,.....kryesues,
 - 1.2. Përparim Shala,.....anëtar,
 - 1.3. Selver Osmanaj,.....anëtar.
2. Detyrat e Komisionit janë: vlerësimi i kërkesave konform shpalljes publike nr. ref. 05-343/82871, të datës 10.07.2026, për subvencionimin e transportit urban , si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë këtë lëmi.
3. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
4. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Komisioni për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
 - Komisionit,
 - Arkivës së Kryetarit.